

U D H Ë Z I M
Nr.3, datë 1.8.1994

PËR ZBATIMIN E DEKRETIT NR.758, DATË 1.2.1994 “PËR NJË MBROJTJE TË VEÇANTË TË USHTARAKUT”

Në bazë të nenit 7 e në zbatim të dekretit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarkaut”, Këshilli i Ministrave

U D H Ë Z O N:

I.1. Për të përfutur pension familjar në masën dhe kushtet e caktuara në nenin 3 si dhe për të përfutur shpërblimet dhe të ardhurat që parashikon neni 4 e 5 i dekretit, qendra e punës dhe familjarët e ushtarakut, sipas rastit, duhet të paraqesin këto dokumente:

a) Vërtetimin e organit të Prokurorisë ose Gjykatës së rrethit ku të shprehet se ushtaraku për shkak të detyrës e si rrjedhojë e veprimeve të dhunshme ndaj tij ka humbur jetën ose aftësinë për punë e shërbim.

b) Vërtetimin e pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit.

c) Çertifikatën e gjendjes familjare.

ç) Vërtetimin e ndjekjes së shkollës kur pjestari në pension është në moshën mbi 18 vjeç deri në 25 vjeç.

d) Çertifikatën e vdekjes së ushtarakut.

e) Kërkesën për pension.

Pjesëtarët e familjes që gëzojnë një pension tjetër duhet të deklarojnë zgjedhjen e pensionit më të favorshëm.

2. Llogaritja dhe pagesa e pensionit familjar do të bëhet nga Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore në rrethe.

3. Buxheti i shtetit do të përballojë diferencën midis pensionit familjar të përfutur në masën dhe kushtet e dekretit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” dhe pensionit familjar të përfutur ose që i takonte të përfitonte nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

4. Pensionet e caktuara sipas nenit 3 të këtij dekreti do të indeksohen sa herë dhe në masën që indeksohen pensionet e përfutura ose që i takonte të përfitonte nga ligji nr.4171, datë 13.9.1996 dhe nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

II.1. Shkalla e humbjes së aftësisë për punë e shërbim të ushtarakut do të provohet me vendim të KMU-së, për rastet e paaftësisë së përkohshme dhe me vendim të KMCAP-it për invaliditetin e përhershëm dhe invaliditetin e pjesshëm të përhershëm.

2. Llogaritja dhe pagesa e të ardhurave për kohën e paaftësisë së përkohshme deri në 12 muaj do të bëhet nga qendra e punës së ushtarakut.

Pas periudhës prej 12 muajsh llogaritja dhe pagesa e të ardhurave për invaliditet të përhershëm ose të pjesshëm të përhershëm do të bëhet nga drejtoritë e sigurimeve shoqërore në rrethe.

3. Buxheti i shtetit do të përballojë diferencat midis të ardhurave për paaftësi të përkohshme dhe invaliditetin të përhershëm e invaliditetin të pjesshëm të përhershëm që përfitohen në masën dhe kushtet e nenit 5 të dekretit nr.758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” dhe atyre të përfutura ose që i takon të përfitojnë në masën e kushtet ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (kapitulli IV neni 43-52).

III. Kompensimi i pagës mujore që kishte ushtaraku, i cili për shkak të aftësive të kufizuara, në bazë të vendimit të KMU-së, caktohet nga organi i emërtesës në një punë a detyrë që paguhet më pak, deri në kohën e riaftësimit të plotë, do të bëhet nga qendra e punës së ushtarakut.

IV. Ndihamat e menjëhershme për rastet dhe në kushtet e nenit 4 dhe paragrafit të 3 të nenit 5 do të caktohen dhe jepen nga qendra e punës së ushtarakut.

V. Efektet financiare në zbatim të këtij udhëzimi do të përballohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore brenda shpenzimeve buxhetore të parashikuara për vitin 1994.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe për ushtarakët që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, pas datës 3.7.1991 efektet financiare fillojnë pas kësaj date.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi